| | |
|---|---|
| **AKT THEMELIMI<br>I<br>SHOQËRISË "SOLDESA ENERGY" SHPK** | **ACT OF INCORPORATION<br>OF<br>THE COMPANY "SOLDESA ENERGY" SHPK** |
| Sot, më 14.02.2023, ortaku i mëposhtëm themelues: | Today, on 14.02.2023, the following founding shareholder, the company: |
| 1) **Shoqëria "Soldesa South Korea" B.V.,** regjistruar në Dhomën e Tregtisë së Holandës me CCI (numër identifikimi) 34311728, me adresë: Strawinskylaan 1431, 1077XX Amsterdam, me ortak të vetëm të saj, **shoqëria "Stichting Administratiekantoor Monet Bis"**, me **anëtar tw vetwm Bordi shoqwrinw "Dutch Trust Management" B.V.**, regjistruar në Dhomën e Tregtisë së Holandës me CCI (numër identifikimi) 34203884, me adresë: Strawinskylaan 1431, 1077XX Amsterdam, përfaqësuar nga **Z.Nikita Maximovich Vinogradov**, dhe **zj.Zoya Georgieva Gyurova**. | 1) **"Soldesa South Korea" B.V.,** registered with the Chamber of Commerce of the Netherlands with CCI (identification number) 34311728, with address: Strawinskylaan 1431, 1077XX Amsterdam, with its sole shareholder, **"Stichting Administratiekantoor Monet Bis"**, having as the sole Board member **"Dutch Trust Management" B.V.**, company registered in the Chamber of Commerce of the Netherlands with CCI (identification number) 34203884, with address: Strawinskylaan 1431, 1077XX Amsterdam, represented by **Mr.Nikita Maximovich Vinogradov,** and **Mrs.Zoya Georgieva Gyurova**. |
| e cila me vullnet të plotë, të lirë e të pacenuar, nënshkruan këtë Akt Themelimi, në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), nëpërmjet të cilit Ortaku Themelues shpreh vullnetin të themelojë shoqërinë "Soldesa Energy" SHPK, me kushtet si më poshtë vijon: | with full, free and unvoiced will, sign this Act of Incorporation, in accordance with the law no.9901, dated 14.04.2008 "On entrepreneurs and commercial companies", as amended, through which the Founding Shareholder express its will to found the company "Soldesa Energy" SHPK, as per the following conditions: |
| **NENI 1<br>Emri i shoqërisë** | **ARTICLE 1<br>Name of the company** |
| 1.1. Emri i shoqërisë do të jetë "Soldesa Energy" SHPK.<br>1.2. Ortaku Themelues i shoqërisë mban përgjegjësi të kufizuar deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara të kapitalit bazë të shoqërisë. | 1.1. The name of the company shall be "Soldesa Energy" SHPK.<br>1.2. The Founding Shareholder of the company bear limited liability in the amount of unpaid signed contributions of the share capital of the company. |
| **NENI 2<br>Forma e shoqërisë** | **ARTICLE 2<br>The form of organization** |
| 2.1. Forma e shoqërisë tregtare "Soldesa Energy" SHPK *(referuar në vijim si "**Shoqëria**")* do të jetë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas parashikimeve të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar). | 2.1. The legal form of organization of the company "Soldesa Energy" SHPK *(hereinafter referred to as "**the Company**")* shall be that of a limited liability company, according to the provisions of the law no.9901, dated 14.04.2008 "On |

| | |
|---|---|
| | entrepreneurs and commercial companies", as amended. |
| 2.2. Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar. | 2.2. The Company shall be an Albanian private legal person. |
| **NENI 3**<br>**Selia e shoqërisë** | **ARTICLE 3**<br>**The seat of the company** |
| 3.1. Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 5. | 3.1. The seat of the company is located in Tirana, at the address: "Deshmoret e Kombit" Boulevard, Twin Towers, Twin 1, 5th Floor. |
| 3.2. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose qytet tjetër brenda Republikës së Shqipërisë, si dhe ka të drejtë të hapë degë ose zyra përfaqësimi të saj kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. | 3.2. The Company has the right to change its seat to a different address and/or city within the Republic of Albania, as well as to establish branches or representation offices anywhere within and outside of the territory of the Republic of Albania. |
| **NENI 4**<br>**Kohëzgjatja e Shoqërisë** | **ARTICLE 4**<br>**Duration of the Company** |
| 4.1. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat kohor të pakufizuar, i cili fillon me regjistrimin e shoqërisë në regjistrin tregtar. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, nëpërmjet një vendimi të posaçëm. | 4.1. The Company shall exercise its activity for an unlimited duration, with the commencement date being that of registration in the commercial register. The shareholders of the Company may decide to limit the term of the activity and then extend it one or several times, by means of a special decision. |
| **NENI 5**<br>**Objekti i veprimtarisë** | **ARTICLE 5**<br>**Object of activity** |
| 5.1. Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë, por duke mos u kufizuar në të: | 5.1. The object of the Activity of the Company shall be, but not limited to: |
| Ndërtimi i sistemeve elektroenergjitike për prodhimin energjisë elektrike nëpërmjet të gjitha formave, përfshirë, por pa u kufizuar nëpërmjet sistemeve te fotovoltaike, eolike, hidrocentraleve mbi burimet hidrike të lejuara nga organet kompetente, ndërtimi i liqeneve artificiale, mbi basene ujore, me qëllim prodhim dhe shitblerje energjie, nëpërmjet koncesionit, partneritetit publik-privat, apo ndonjë forme tjetër të parashikuar nga ligji për të ushtruar këtë aktivitet. Ndërtim, projektim, zbatim të të gjitha linjave dhe sistemeve te interkonjeksionit për përcjelljen e energjisë elektrike. Realizimin e projekteve koncesionare dhe/ose partneritet publik-privat me institucione të pushtetit qendror dhe autoritetet vendore, në fusha të ndryshme, për vete apo për persona të tretë, përfshirë edhe asistencën dhe konsulencën teknike, ligjore, financiare, fiskale | Construction of electrical energy systems for the production of electricity through all forms, including, but not limited to, photovoltaic, wind, hydropower plants on water resources allowed by the competent bodies, the construction of artificial lakes, on water basins, with the purpose of production and sale and purchase of energy, through concession, public-private partnership, or any other form provided by law to exercise this activity. Construction, design, implementation of all lines and interconnection systems for transmission of electricity. Implementation of concessionary projects and/or public-private partnerships with central government institutions and local authorities, in various fields, for themselves or for third parties, including technical, legal, financial, |

kundrejt shoqërive tregtare dhe/ose institucioneve publike ne kryerjen e procedurave koncesionare dhe/ose parneriteteve publike - private në çdo sektor apo edhe kundrejt palëve të tjera financiare, tregtare, apo te tjera. Ne përgjithësi, kryerjen e çdo veprimtarie tregtare, industriale apo transaksioni me pasuritë e luajtshme dhe te paluajtshme që lidhen me objektin e lartpërmendur të shoqërisë. Import, eksport, shitblerje, tregtim dhe furnizim me shumicë dhe pakicë të energjisë elektrike, brenda dhe jashtë vendit. Sipas legjislacionit ne fuqi, shoqëria mund te kryeje çdo aktivitet te konsideruar te dobishëm apo të nevojshëm, për arritjen e objektivave të saj, i cili lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo me objektin e veprimtarisë dhe është në përputhje me legjislacionin ne fuqi.

**NENI 6**

**Kapitali dhe Kuotat e Shoqërisë**

6.1. Kapitali bazë i Shoqërisë është në vlerën ALL 100 (njëqind lekë).

6.2. Kapitali bazë i Shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë, e cila zotërohet nga Ortaku Themelues, shoqëria "Soldesa South Korea" B.V., me vlerë nominale prej ALL 100 (njëqind lekë), e cila i jep të drejtën e pjesëmarrjes prej 100% (njëqind përqind) në kapitalin bazë të shoqërisë.

6.3. Kapitali bazë i Shoqërisë është nënshkruar dhe paguar në tërësinë e tij nga Ortaku Themelues.

**NENI 7**

**Organet Drejtuese**

7.1. Bazuar në dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), organet drejtuese te shoqërisë janë:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve — organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori — organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.

7.2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

fiscal assistance and consultancy toward commercial companies and/ or public institutions in carrying out concession procedures and/or public-private partnerships in any sector or even toward other financial, commercial or other parties. In general, the performance of any commercial, industrial activity or transaction with movable and immovable assets related to the above-mentioned object of the company. Import, export, sale, trading and wholesale and retail supply of electrical energy, domestically and abroad. According to the legislation in force, the company may carry out any activity considered useful or necessary, for the achievement of its objectives, which is directly or indirectly related to the object of the activity and is in accordance with the legislation in force.

**ARTICLE 6**

**The Capital and the Shares of the Company**

6.1. The share capital of the Company shall be ALL 100 (one hundred Albanian Lek).

6.2. The share capital of the Company constitutes in 1 (one) share, owned by the Founding Shareholder, "Soldesa South Korea" B.V., with a nominal value of ALL 100 (one hundred Albanian Lek), which grants him the right to participate with 100% (one hundred percent) in the share capital of the company;

6.3. The Founding Shareholder has signed and paid the share capital of the Company in its entirety.

**ARTICLE 7**

**Governing Bodies**

7.1. Based on the provisions of law no. 9901, dated 14.04.2008 "On entrepreneurs and commercial companies", as amended, the governing bodies of the company are:

1. The General Assembly of Shareholders - the highest decision-making body;
2. The Administrator - the executive and administrative body of the Company.

7.2. The way of their organization and functioning is specified in the Articles of Association of the Company.

| | |
|---|---|
| **NENI 8**<br>**Administrimi** | **ARTICLE 8**<br>**Administration** |
| 8.1. Shoqëria do të administrohet nga Administratori i saj, i cili mund të emërohet për një afat deri në pesë vjet me të drejtë riemërimi. | 8.1. The company shall be administered by its Administrator, who can be elected for a term of up to five years with the right of reappointment. |
| 8.2. Administrator i vetëm i shoqërisë "Soldesa Energy" SHPK do të jetë **Z.Dorian KALLESHI**, shtetas Shqiptar, lindur me 30.01.1981 në Shkodër dhe banues në Tiranë, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit ID me nr. personal I10130112Q, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, i cili autorizohet për të kryer të gjitha procedurat e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. | 8.2. The sole administrator of "Soldesa Energy" SHPK shall be **Mr.Dorian KALLESHI**, of Albanian citizenship, born on 30.01.1981 in Shkodra, Albania and residing in Tirana, identified through ID with personal no. I10130112Q, adult, enjoying full legal capacity to act, who is authorized to perform all company registration procedures at the National Business Center. |
| 8.3. Administratori i sipërcituar emërohet për një afat 3 (tre) vjeçar me të drejtë riemërimi, duke nisur ky afat nga data e regjistrimit të tij pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. | 8.3. The abovementioned administrator is appointed for a 3 (three) year term, with the right of reappointment, starting from the date of registration at the National Business Center. |
| 8.4. Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqerisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi, apo nga një ose disa persona të autorizuar prej tij. | 8.4. The company shall be represented in front of each and every administrative or judicial organ, every other public or private entity and in its relationships with third parties, by its Administrator, who exercises his rights in accordance with the Articles of Association of the Company and the Albanian laws in force, or by one or more persons authorized by him. |
| **NENI 9**<br>**Ligji i aplikueshëm** | **ARTICLE 9**<br>**Applicable law** |
| 9.1. Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, ky Akt Themelimi, si dhe parashikimet e Statutit të saj. | 9.1 The activity of the Company is regulated by the legislation in force in the Republic of Albania, this Act of Incorporation, as well as the provisions of its Articles of Association. |
| **NENI 10**<br>**Regjistrimi** | **ARTICLE 10**<br>**Registration** |
| 10.1. Shoqëria do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga Administratori dhe/ose një/disa person(a) të autorizuar prej tij për këtë qëllim, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | 10.1. The company shall be registered at the National Business Center by the administrator and/or one/several person(s) authorized by him for this purpose, in accordance with applicable law. |
| **NENI 11**<br>**Dispozitat përfundimtare** | **ARTICLE 11**<br>**Final provisions** |
| 11.1 Ky Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje në shqip dhe në anglisht dhe nënshkruhet nga | 11.1 This Act of Incorporation is compiled in 3 (three) copies in Albanian and in English and |

| | |
|---|---|
| Ortaku Themelues i shoqërisë "Soldesa Energy" SHPK. | is signed by the Founding Shareholders of "Soldesa Energy" SHPK. |

**ORTAKU THEMELUES: / FOUNDING SHAREHODLER:**

**SOLDESA SOUTH KOREA B.V.**
**PËRFAQËSUAR NGA ANËTARI I VETËM I BORDIT: DUTCH TRUST MANAGEMENT B.V:/**
**REPRESENTED BY THE SOLE BOARD MEMBER: DUTCH TRUST MANAGEMENT B.V:**

_______________________

*Përfaqësuar nga: / Represented by:*
Z./ Mr. Nikita Maximovich Vinogradov

_______________________

*Përfaqësuar nga: / Represented by:*
Zj./Mrs. Zoya Georgieva Gyurova

Jam dakort për emërimin si administrator.

Dorian Kalleshi